

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS  
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS  
BOTIME TË VEÇANTA CLXXIV  
SEKSIONI I ARTEVE  
LIBRI 24

TAHIR EMRA

ABDURRAHIM BUZA  
(MONOGRAFI)

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS  
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS  
SPECIAL EDITIONS CLXXIV  
SECTION OF ARTS  
BOOK 24

TAHIR EMRA

ABDURRAHIM BUZA  
(MONOGRAPH)

Approved for publication at the meeting of the Section of Arts,  
held on 17<sup>th</sup> January, 2018, after review by  
correspondent member Luan Mulliqi and professor Hivzi Muharremi.

Editor: Correspondent member Luan Mulliqi, Secretary of the Section of Arts.



AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS  
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS  
BOTIME TË VEÇANTA CLXXIV  
SEKSIONI I ARTEVE  
LIBRI 24


TAHIR EMRA

ABDURRAHIM BUZA  
(MONOGRAFI)

U miratua për botim në mbledhjen e Seksionit të Arteve,  
mbajtur më 17 janar 2018, në bazë të recensioneve të  
anëtar korrespondent Luan Mulliqit dhe profesor Hivzi Muharremit.

Redaktor: Anëtar korrespondent Luan Mulliqi, Sekretar i Seksionit të Arteve.





Abdurrahim Buza  
(1905-1986)

(Foto P. Sulo)  
1978

*Falënderim:*

*Familja BUZA,  
Selektorin dhe fotografin Xhoi Guga*

## TAKIMI I PARË ME ABDURRAHIM BUZËN

Doajenin e pikturës shqiptare, Piktorin e Popullit, Abdurrahim Buzën (1905-1986), Bacën Abdurrahim, siç e quanim me bashkëvendasit e tij, kam pasur fatin ta njoh qysh në dhjetor të vitit të largët të shekullit të kaluar, më 1971, me rastin e vizitës së parë zyrtare në Tiranë, të grupit treanëtarësh meritor (piktor akademik prof. Muslim Mulliqi, skulptor akademik prof. Svetomir Arsiq dhe piktor akademik prof. Tahir Emra).

Kjo vizitë pesëmbëdhjetëditëshe ishte historike, e rëndësishme dhe shumë e suksesshme, se, në vitet në vazhdim, solli bashkëpunim, shkëmbim të ekspozitave, të kuadrove dhe të manifestimeve artistike.

Ndër vizitat e para të shënuara në program, ishte ajo e studios së piktorit të njohur Abdurrahim Buza. Pasi u konfirmua vizita, e cila ishte paralajmëruar më parë, Muslimi dhe unë u nisëm drejt banesës së familjes Buza, dhe, meqë s'ishte larg hotelit "Dajt", aty ku ishim të vendosur, mbërrimë shpejt, në kohën e caktuar. U mirëpritëm ngrohtësisht e përzemërsisht dhe me lot në sy - në përqafim.

Hymë në një dhomë dhe u ulëm. Përballë kishim një familje të vjetër qytetare Gjakovare me tradita patriotike. Përballë kishim një burrë fisnik, intelektual dhe piktor të veçantë. Përballë kishim njeriun markant kosovar, që në zemër kishte Kosovën.

Fliste me admirim për Kosovën. Ishte përmalluar për Gjakovën, Kosovën. Shprehte dashuri për Kosovën.

Shpërthente nga emocionet në momente. Ishte sa i urtë dhe i heshtur, aq edhe ndryshe, kosovar, në gjithë qenien e tij.

Edhe pse nga Kosova, në moshë të re, ishte larguar për shkollim, në memorien e tij ishin ngulitur ngjarjet, njerëzit, të afërmit, rrugët, lagjet, shokët e fëmijërisë, pastaj Çabrat (një kodrinë bleroshe në Gjakovë) etj., deri te era e lagësht e Erenikut (lumë në Gjakovë).

Me lot në sy e përmallim fliste për odat e burrave, për tingujt e qemaneve, për lojën me kapuça etj. Në sytë e tij, të mallëngjyer, ne shihnim Gjakovë, Kosovë.

Dhe më pas, kur biseda kaloi në fushën e artit, shkuam në studio (atelië), që ishte në kuadër të banesës, ku na tregoi vizatimet, pikturat në teknika të ndryshme, të cilat ishin në numër shumë të madh.

Dhe pas qëndrimit bukur të gjatë, u ndamë të përqafuar. I premtuam që dëshirën e tij të flaktë për ta vizituar dhe për të ekspozuar në Kosovë, do ta bëjmë realitet.

# ABDURRAHIM BUZA - PIKTORI I PARË I ARTIT MODERN SHQIPTAR

**ABDURRAHIM BUZA** është një ndër personalitetet më të shquara të pikturës shqiptare. Ai është piktori i parë modern, i pangjashëm dhe i pakrahasueshëm shqiptar i shekullit XX-të.

Ai shquhet për stilin e tij original, që buron nga forca intuitive e talentit dhe e karakterit sugjestiv emocional, në pasqyrimin e motiveve kombëtare.

Vepra piktorale e "Piktorit të Popullit" Abdurrahim Buza është shumë e gjerë, shumëplaneshe, e larmishme dhe e vlerësuar lart nga studiuesit dhe kritika si një zë i rëndësishëm dhe i veçantë me nota të theksuara kombëtare.

Veprën e Abdurrahim Buzës e përshkon mendimi i thellë i ekzistencës kombëtare, i atij ashti qëndrese të fortë që nuk thyhet lehtë. Në këtë asht të fortë është edhe lindja, edhe vallja edhe dasma. Mendimi i ekzistencës kombëtare ka rëndësi të veçantë filozofike. Tipareve, zakoneve, të dasmës, të lindjes, të vdekjes, të luftës etj., e të zakoneve dhe të mënyrës së jetesës, nuk ka pasur ç' tu bëjë asnjë rrebesh i kohës - ato kanë vazhduar të jetojnë, duke ruajtur originalitetin e tyre kombëtar.

Karakterit individual i krijimtarisë figurative të tij dhe i originaliteti kombëtar që shprehet përmes një stili të dallueshëm dhe të pakrahasueshëm nga të tjerët me plot harmoni, me muzikalitet, me variacione të temave dhe ideve, me një paletë të pasur me ngjyra, e bën krijimtarinë figurative të A. Buzës një album të çmuar në vlerat e mëdha të artit tonë kombëtar.



**Hidrocentrali "Karl Marks"** - cikel  
laps, flamaster / letër  
31 x 22 cm



Në Shtigjen, 1973  
laps / letër  
26,5 x 28 cm

Krijimtaria e tij në pikturë që ai krijoi në vitet e para të kthimit nga Italia, ku i mbaroi studimet, i përket disa portreteve dhe peizazheve që i pikturon në qytetin e Pogradecit, ku i kalonte pushimet te të afërmit e tij. Ndër këto tablo janë: **"Vajza me kordele të kuqe"**, **"Nasta"**, **"Portreti i motrës së Nastës"**, **"Manushaqja"**, **"Gruaja që ushqen dhinë"**, **"Portretet e dy kushërinjve të tij"**, **"Brendi shtëpie"** etj. Këto vepra u përkasin viteve 1934-1935.

Abdurrahim Buza pikturoi të parën nudo të një shqiptareje në Shqipëri (Tiranë, 1935), në kohën kur vajza Tiranase ishte e mbuluar me fereuxe.

Me 1934, ai pati një ofertë nga pallati i Mbretit Zog për të realizuar një afresk, kërkesë të cilën ai e refuzoi me pretekstin se ishte mjaft i ri për këtë punë të rëndësishme e me përgjegjësi. Në fakt arsyeja e vërtetë ishte se ai nuk pranoi t'i shërbente Mbretit, kundër të cilit, në vitin 1924 ishte pjesëmarrës në lëvizjen demokratike antizogiste.

Në vitin 1938, Abdurrahim Buza ftohet të marrë pjesë në konkursin (ekspozitën) **Premio Albania**, duke realizuar veprën **"Nëna dhe fëmijët"**, të cilën nuk e ekspozoi dhe, që sot, nga e gjithë tabloja ruhet portreti i një fëmije me profil (fragment të prerë nga tabloja), që njihet me titullin **"Kokë fëmije"** dhe ndodhet në Galerinë Kombëtare të Arteve të Tiranës.

Në vizatimet, skicat, kroatë e tij, të cilat janë në numër shumë të madh, të punuara me laps, pendë-tush, brushë etj., zënë vend portretet - figurat e malësorëve të Shqipërisë së Veriut, Malësisë së Gjakovës, Kosovës, pastaj shtëpitë fshatare të këtyre zonave, festat popullore, dasmat, skenat nga jeta e përditshme e fshatit, etj., të gjitha këto të punuara me një sensibilitet dhe përjetim të thellë.

Abdurrahim Buzën e shohim në ekspozitën e parë të hapur më 7 prill 1945, krahas 29 artistëve të tjerë figurativë. Ai prezantohet aty me disa punime si **"Dasma Kosovare"**, **"Pogradeci"**, **"Lagja ime"**, **"Kokë vajze"** etj.

Gjatë viteve në vazhdim, deri më 1960, njihen nga piktori disa tablo të cilat janë: **"Puna vullnetare në Kombinat"** (1948), **"Nusja kosovare"** (1950), **"Dimër në Tiranë"** (1953), **"Një pjatë rrush"** (1957), **"Autoportret"** (1968).

Në vitin 1959, Abdurrahim Buza, shkon në Egjipt për të hapur pavijonin e artit shqiptar në Bienalen e Aleksandrisë, ku ai merr pjesë me tablonë **"Nëna e deshëruar"**. Në vitin 1961, ai udhëton në ish-BRSS, në disa qytete, si Moskë, Shën Petersburg, etj., për 15 ditë, ku takohet me artistë rusë të cilët më parë kishin ekspozuar në Shqipëri.

**Rruga e Dritës**  
flamaster / letër  
22 x 28,5 cm



Abdurrahim Buza, në vazhdim të krijimtarisë trajton më shumë tema patriotike, e të tjera, kryesisht nga Kosova, tema këto të rindërtuara në memorien e artistit, ku psikologjia dhe gjendja shpirtërore e njerëzve të trevës së tij, janë shumë më të forta se pamja e tyre e jashtme.

Kemi në kujtesë pikturat "**Refugjatet**", "**Malësori**", "**Vajza Gjakovare**", "**Dasma Gjakovare**", "**Lojërat popullore**", "**Azem Galica dhe luftëtarët**". Ato nuk janë thjesht figura, por shpirtra të figuralizuara sipas kujtesës se hershme pamore të ruajtura në vatrat e trurit të artistit.

Motivet nga vendi i tij zënë vendin kryesor, dhe sot ruhen si vepra të një vlere unike, të papërsëritshme në historinë e artit figurativ shqiptar, të cilat kanë lindur tërësisht prej meditimit figurativ të artistit.

Abdurrahim Buza mbeti modeli i artistit konsekuent, i cili aspironte për një art të vërtetë, e që kontribuonte në shtrimin e urave të komunikimit me artin bashkëkohor evropian, duke ruajtur personalitetin dhe vlerësuar traditat kombëtare. Ai punoi dhe jetoi duke ruajtur fort moralin dhe dinjitetin artistik.

Prej veprave të tij, sot ruhen 500 tablo të realizuara në teknika të ndryshme dhe 10,000 vizatime. Në Galerinë Kombëtare të Arteve (GKA) në Tiranë ruhen 59 punime të piktorit Buza.


Pjesa më e madhe e veprave të tij ruhen në Studion-Muze Buza dhe në disa koleksione private dhe shtetërore.

Në Galerinë Sukarno (Indonezi) gjendet tabloja "**Vajtimi**", dhuruar në vitin 1957 në Bienalen e Aleksandrisë, pas vlerësimit "ekstraordiner", që presidenti i atëhershëm i Indonezisë i bëri kësaj vepre.

Në muzeun botëror të Olimpizmit në Lozanë (Zvicër) gjendet kompozimi i tij "**Kala dibrance**".

Abdurrahim Buza ka mbi 50 punime të dimensioneve të ndryshme të dhuruara miqve dhe të afërmeve në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni dhe troje tjera shqiptare.

**Tahir Emra**  
Prishtinë, 2017



**Hidrocentrali "Karl Marks" - cikël**  
laps, flamaster / letër  
31 x 22 cm

## PËR ABDURRAHIM BUZËN KANË THËNË

"Brezi i ri i artistëve tanë e kanë kuptuar drejt personalitetin artistik të Abdurrahim Buzës, e dashuron atë, e nderon atë si mjeshtër të artit. Aq më tepër është e sinqertë dhe e rrënjosur kjo dashuri se bazohet kryesisht në bindjen që lind nga njohja direkte e njeriut dhe veprave.

Abdurrahimin e kam pasur nga miqtë më të mirë, me të cilin themelova Shkollën e Vizatimit në Tiranë nga dolën artist të rinj të talentuar".

**ODHISE PASKALI, Tiranë, dhjetor, 1960**

"Vite pune të palodhur... Vite, kur artisti i vërtetë rropatet për të gjetur të vërtetën... pasion ngjyrash të gjalla... larmi e freski, si lule të paventura, që rriten vetëm në truallin e shenjtë amtar - të gjitha këto i gjejmë në punimet e Profesor Buzës".

**ROBERT SHVARC, dhjetor, 1960**

"Optimizmi, pastërtia, fryma djaloshare dhe shija e lartë artistike, karakterizojnë punimet e këtij njeriu të qetë dhe të thjeshtë, por që me veprat e tij flet kaq shumë".


**VISLON KILICA, dhjetor, 1960**

"Merita e Abdurrahim Buzës nuk qëndron vetëm në vlerat e tij si njeri dhe pedagog, por edhe si piktor i talentuem me cilësi artistike..."

**SADIK KACELI, dhjetor, 1960**

"Të gjithë gëzohemi me gjithë shpirt për talentin e fuqishëm të këtij artisti, që na jep aq bukur dhe me vërtetësi natyrën dhe tipat shqiptar. Kujt nuk i flet malësori kosovar, krenar, se na nuk shtrohemi..."

**NONDA BULKA, 1960**



Rruga e dritës, 1966

laps / letër

31 x 22 cm

"Veprën e A. Buzës e përshkon mendimi i ekzistencës kombëtare, i asaj kocke të fortë, që nuk thyhet, sado që të epet. Në këtë kockë është edhe lindja, edhe vdekja, edhe lufta për përparim e liri, edhe vallja, edhe dasma... Originaliteti kombëtar dhe karakteri individual i krijimtarisë së tij, që shprehet përmes një stili të dallueshëm nga të tjerët, plot muzikalitet, variacione temash dhe idesh, plot ngjyra në harmoni dhe në përputhje me ngjarjet, e bën veprën e Buzës një koleksion të çmuar në vlerat e mëdha të artit tonë kombëtar..."

**DRITËRO AGOLLI, dhjetor, 1975**

"Piktura dhe vizatimit e Abdurrahimit janë të papritura, botë shqiptare e një artisti të madh të një vendi të vogël, që pata fat ta njoh dhe shoqëroj në ditët e tij në Akeksandri."

**SEIFWANLY, Piktur Akadematik**

Në plejadën e figurave të dalluara të kulturës kombëtare, shqiptare, zë vend të rëndësishëm dhe piktori i madh i popullit shqiptar, gjakovari Adburrahim Buza, emrin e të cilit për veprën e tij monumentale do të jetojë përjetshëm në historinë e kulturës shqiptare dhe më gjerë.

**Prof. ALI HADRI, Historian, Gjakovë, 1980**


"Këtu në Shqipëri erdha për të zbuluar naftë, por në studion Buza gjeta flori, vlera të mëdha artistike dhe kulturore. Plaku Buza është një perlë e këtij populli, që shkëlqen deri në vendin tim. Herën tjetër do të vij me shokë e miq të shquar."

**WILLIAM E. JAMES, Citizens Energy Corporations**



**Hidrocentrali "K.Marks", 1971**  
laps / letër  
31 x 22 cm

**Hidrocentrali "Karl Marks"** - cikël  
laps, flamaster / letër  
31 x 22 cm



"Për mikun tim të shtrenjtë, piktorin e madh Abdurrahim Buza, në ditët e hidhërimit, kur ai, një nga perlat që e bënin më të bukur, më të dashur e më të kthjellët këtë vend e këtë komb, iku nga mesi ynë duke na lënë një brengë, që si çdo gjë e tij është e xhevahirtë e plot dritë"

**ISMAIL KADARE, 1986**

"Humbja e Abdurrahim Buzës dhe Odhise Paskalit lënë një zbrazëtim të madhe në jetën kulturore të botës sonë. Ata janë mjeshtrit (mësuesit) e parë, që na dhanë njohurinë e parë drejt poezisë së ndjeshme të artit. Emrat e tyre do të qëndrojnë të gjallë në kujtesën tonë"

**IBRAHIM KODRA, Milano, shkurt 1987**

"E kam dashur e çmuar shumë Abdurrahimin, për artin e tij, për thjeshtësinë dhe fisnikërinë e shqiptarit nga Kosova, i së cilës ai mbetet një nga bijtë më të shquar..."

"...kam pasur fatin të kem të bëj me njerëz nga më të shquarit e kulturës sonë kombëtare, të cilëve, sekush e të gjithë, u detyrohemi aq shumë. Tek A. Xhuvani, E. Çabej, O. Paskali, A. Buza, I. Kadare me shokë, ngrihet lartë mendimi dhe ndjenja për të përsosurën, nuk rresh munda për begatimin shpirtëror të Kombit. Sepse ata ditën aq mirë t'a çmojnë kulturën mijëvjeçare të shqiptarëve dhe sepse ditën të përfitojnë aq mirë prej kulturës së të tjerëve..."

**Prof. DR. DHIMITËR SHUTERIQI, mars 1988**

"A. Buza e pasuron pikturën tonë realiste, çel shtigje të reja, që e zgjerojnë vizionin e saj... Në këtë kuptim, krijimtaria e tij është një mësim instruktiv për të sotmen dhe të ardhmen, për ta nxjerrë pikturën në rrugë të reja novatore".

**Prof. DR. ALFRED UÇI, maj 1989**

"Proceset e reja janë pozitive, por tepër frontale. Mungon një lokomotivë. Një piktor i rangut të Buzës."

**AGRON BREGU, Piktor, 'Zëri i Rinisë', shtator, 1990**

"Më është dashur fjala vjen, sa e sa herë, t'ua rrëfej shokëve të mi të epokës, vizitën që bëra tek Abdurrahim Buza. Plakut të gjatë e të përhumbur mes kujtimeve i detyrohem për një nga ditët më të bukura të adoleshencës. Më tregoi qindra nudo të vetat, vizatuar me një linjë të pastër, dëshirash qumështore, e pastaj, si të ma kishte lexuar në ballë ëndjen, më vuri përpara dy blej, SKIRA të impresionizmit, duke më kredhur me buzagazin e tij të ëmbël në tërë atë adet ngjyrash e transparencash pa fund, nga ku dola me disa këmbë që mezi i bëra zap, për të rendur e t'u rrëfyer drejt e tek shokët."

**EDI RAMA, Paris 1997**

**(Në parathënien e KANDINSKIT, shqipëruar nga ai)**

"Piktori Abdurrahim Buza është një emër i njohur, për të cilin dinë të gjithë shqiptarët kudo jetojnë ata.

Kur bëhet fjalë për krijimtarinë e tij artistike, dy nocione janë të pashmangshme: autentike dhe origjinale. Autentike janë temat që ka trajtuar ai. Origjinale është puna e tij, stili i tij, shprehja e tij artistike. Abdurrahim Buza në të vërtetë me mjetin e pikturës ka shkruar historiografinë dhe etnografinë shqiptare. Ai na flet me këtë mjet në radhë të parë për Kosovën lëndore dhe Kosovën shpirtërore, na flet për përjetimet, pësimet dhe fitoret, dëshirat, synimet e popullit shqiptar në Kosovë, në Shqipërinë shtetërore dhe në përgjithësi kudo qofshin ata. Figurat e ndryshme historike të të gjitha trevave shqiptare, ngjarjet e rëndësishme të jetës kombëtare, dasmat, vallet, adetet dhe zakonet e ndryshme, përjetimet e ndryshme, të gjitha këto janë përmbajtja e tij, janë temat e mëdha për të cilat ai flet gjithnjë. Ai e shkruan me mjetin e pikturës jetën dhe historinë e popullit të tij. Por, me figurat që paraqet në pikturat e tij, ai e bën njësinë e popullit, të tijën.

Abdurrahim Buza e shkruan atë që e ka përjetuar dhe atë që dëshiron ai vet për popullin e tij. Me këtë punë të tij, në kuptimin e temave të tij me domethënien e tyre, me bukurinë e shprehjes së tyre, ai e ka mbërritur atë që e mbërrijnë të gjithë krijuesit e shquar, në të vërtetë të gjithë krijuesit e mëdhenj, ka hyrë përgjithmonë në kujtesën e popullit, aty e gjeta edhe unë për këtë emision, kur e kërkuat të them disa fjalë për të".

**REXHEP QOSJA, Prishtinë, gusht 1999**

"Abdurrahim Buzën unë e quaj themeluesin e artit modern shqiptar. Ka polivalencë në traditë, tematikë dhe të krijon vizionin modern të ngjyrave. Ai është dalluar për mjeshhtërinë e mësimdhënies në degën e pikturës, kishte background shumë të pasur dhe ishte një patriot. Ai ishte shkolluar në Itali dhe ka ndikuar shumë në edukimin e gjithë brezave"

**NAZMI HOXHA, Tema, prill, 2003**

"... Abdurrahim Buza, emër i madh i artit tonë figurativ kombëtar, bazament i shëndoshë i tij. I veçantë në individualitetin e tij krijues, por i përbashkët në kontributin e gjithë artistëve paraardhës dhe bashkëkohës të tij, e përsëri më dukshëm në llojin e vet. Ai që njeh sado pak krijimtarinë e Buzës nuk ka se si të mos pohojë mjeshtërinë dhe artin e madh, të veçantë, origjinal e të papërsëritur.

Kam pasur fat si shumë e shumë të tjerë të jem nxënës i Buzës. Këtë privilegj e ruaj sot e do ta gëzoj vazhdimisht."

**SKËNDER MILORI, Pikturor, Tiranë, dhjetor, 2005**

"... Abdurrahim Buza mbështetet thellësisht në traditën e pasur kostumografike popullore mbarëshqiptare. Në koloritin e jashtëzakonshëm popullor ai krijoi një kompozim simbolik përgjithësues titulluar "**Shqipëria vallëzon**" e cila u bë emblemë e të gjitha festivaleve popullore kombëtare shqiptare.... Ajo i ngjanë një rozete ku burrat dhe gratë kapur dorë për dorë hedhin valle në lëndinën e bleruar shqiptare me veshjet karakteristike të të gjitha krahinave shqipfolëse. Tri ngjyrat simbolike të kostumeve shqiptare - e bardha, e kuqja dhe e zeza përkrijnë në mënyrë simbolike me hënën e bardhë, të kuqe dhe të zezë, si besime të lashta pellazge.

Me një pelenatë të gjallë e të ngrohtë ai do të jap zgjedhje të pasura karakteresh të personazheve, duke u nisur nga shprehja subtile, psikologjike dhe format delikate të fëmijës në veprën "**Kokë djali**" (fragment) e deri te figurat e rraskapitura e të vrazhdësuar nga barra e jetës, siç janë personazhet e pleqve në veprën "**Refugjatët**", pikturuar më 1957.

**Prof. Dr. HIVZI MUHARREMI, Historian dhe Kritik i Artit)**  
**Prishtinë, Prill 2017**



**Rruga e Dritës**  
flamaster / letër  
22 x 28,5 cm



**Hidrocentrali "K.Marks", 1971**  
laps / letër  
31 x 22 cm

## AKADEMIA ALBERTINA

Edhe pse emri "Albertinë" to çon de Karlo Alberto i Savojës, të cilit i detyrohet "rithemelim" përfundimtar i akademisë më 1833, zanafilla e saj është shumë më e largët, aq sa akademia torineze mund të konsiderohet një prej më të vjetrave të Italisë. Qysh në gjysmën e parë të shek. të 17 në Torino është aktiv një "Universitet i Pikturëve, Skulptorëve dhe Arkitektëve", që më 1652, bëhet "Shoqëria e Shën Lukës" (Compagnia di S. Luca) dhe që do marrë për herë të parë – por përfundimisht – emrin akademi më 1678, kur Maria Xhovana Savoja-Nemaurs, e veja e Karlo Emanuele II themelon Akademinë e Pikturëve, Skulptorëve dhe Arkitektëve, duke u frymëzuar nga modeli i Akademisë Mbretërore të Parisit. Pas reformash të tjera nën Vitorio Amadeon II (1778) dhe, më pas, nën sundimin napolenian, rreth vitit 1883 realizohet një "rithemelim" i mirëfilltë, vepër e Karlo Albertos: "Akademisë Mbretërore Albertine" i jepet një seli e re në ndërtesën që zë sot e kësaj dite; gjithashtu akademisë i dhurohet një pinakotekë e rëndësishme, ku janë bashkuar koleksionet e markezit imzot Mosi i Moranos dhe kartonat e vyer të Grandencios, ish pronë e dinastisë savojase. Midis fundit të shek. Të 19 dhe fillimit të shek. të 20 akademinë përcjell denjësisht kalimin nga realizmi në artin e ri, në drejtim të eklektizmit, të stilit Liberty dhe të një përtëritjeje të tematikave, me pikturën e peizazhit dhe të zhanrit, që sheh si protagonist Antonio Fontanezin, Xhakomo Grosone (pedagog i A. Buzës, që ndikoi me konceptimin koloristik dhe me strukturat kompozicionale të tablosë, larinë e penelatave dhe ngjyrat e theksuara), dhe Çezare Ferron një tjetër mjeshtër i shquar i pikturës së kavadetit, plot nuance dhe vibrime ngjyrash që influencoi në ruajtjen e origjinalitetit të A. Buzës. Skulptorët Viçence Velos, Odoarale Tabaki dhe Eduarolo Rubino (në studion e të cilit punoi mbi gjashtë muaj skulptori O. Paskali) ndikuan me modelimin e formave dhe vëllimeve plastike skulpturore. "Albertina" e ndërmerr ndryshimin e saj të fundit në fillim të viteve '40' me mbështetjen e disa përfaqësuesve të rëndësishëm të kulturës figurative torineze të njohur me modelet e avangardës europiane qendrore dhe franceze, Kosovati, Pauluçi, dhe më pas Mencio për pikturën, Kerki për skulpturën, Kalandri për gdhendjen, Kaneklini për skenografinë, me bashkëpunimin shumë të mirë të ndihmësve të vlefshëm si Galivao, Skropo, Daviko, që dokumentojnë zhvillimet e artit menjëherë pas luftës. Në këto vitet e fundit Akademia Albertine është transformuar dhe përtërirë më tej, duke promovuar nisma të shumta dialektike dhe kulturore, futja masive e informatikës dhe kursi i konservimit dhe restaurimit.

**Peisazh, 1958**  
flamaster / letër  
45 x 54 cm

**Pamje nga Divjaka, 1960**  
laps / letër  
45 x 54 cm



## XHAKOMO GROSO

Ishte i pari mësues me të cilin kontaktoi A. Buza në fillim, një mjeshtër dhe pedagog që kuptoi talentin, dhuntitë dhe dobësitë e piktorit shqiptar. Që diti ta ruajë, mbrojë dhe kallëzojë për më tej.

Xhakomo Grosso, bir i një marangozi fare të varfër në Kambiono, i dashur për të gjithë korinezët, u bë në fillim të shekullit senator për famen e tij të madhe. Plot çmime, vlerësime nderi dhe medalje të arta ju dhanë në ekspozita të ndryshme, në Venecie, Milano, Paris, Muni, Vjenë etj.

Toskanini e mbante portretin e realizuar prej tij më 1916, si më të mirin që i ishte bërë, njësoj të shkëlqyera ishin portretet e Puçinit dhe Dekanit, Grosjoja u ngarkua të realizonte portretet zyrtare të mbretit, mbretëreshës e madje të Papës Benedikti XV.

Edhe "Nudo" e viti 1896, me të gjitha variantet që e pasuan në vite, u censurua nga moralistët sepse që tepër e guximshme, më e përshtatshme për një gjumi se për një sallon publik.

E pra ky piktor ndikoi te A. Buza në modelimin e saktë dhe vizatimin ekspresiv.

## ÇEZARE FERRO MILONE (1880-1934)

Ka qenë mësuesi tjetër i A. Buzës në Akademinë "Albertina" të Torinos. Italian i lindur në Torino, ku edhe ishte drejtor dhe president i Akademisë "Albertina" të Arteve të Bukura. Më 1906 ai mori një porosi në Tailandë.



**Rruga e Dritës**  
flamaster / letër  
22 x 28,5 cm

# AKADEMIA E ARTEVE TË BUKURA TË FIRENCS

Në Mesjetën e vonë midis organizatave korporative të quajtura "Artet" lindi më 1339 Shoqëria e Shën Lukës, që greponte piktorët e qytetit, e cila i kushtojte shenjtorit që sipas legjendës, kishte pikturuar një portret çudibërës të Virgjëreshës.

Një akademi artistike, në një kuptim me alialaktik ishte zhvilluar edhe në shek. 15-të në Parkun tashmë të zhdukur të San Markos, ku Lorenzo Madhështori kishte vendosur koleksione të skulpturave antike, duke ngarkuar skulptorin Bertoloblo që nëpërmjet mësimin të teknikave artistike, të kopjoheshin nga të rinj të pajisur me talent artistik, mes të cilëve spikati menjëherë i riu Mikelanxhelo Buanarroti.

Prej këtyre bërthamave të para të bashkëpunimit midis artistëve u zhvillua më 1563 "Akademia e Arteve të Vizatimit", e lindur nën mbrojtjen e Dukës së Madh Kozino I dhe nën drejtimin e Xhorxho Vasarit, ndoshta i pari institucion i këtij lloji në Europë. Mes detyrave të shoqërisë, në fakt, ishte vendosur jo vetëm bashkëpunimi në mes të anëtarëve, administrimi dhe ruajtja e trashëgimisë artistike toskane, por edhe mësimi i arteve dhe i shkencave nga nxënësit e rinj.

Rektorët e parë të akademisë, me votim të njëzëshëm, ishin vetë Kozino I dhe artisti më i madh i gjallë në atë kohë, Mikelanxhelo, i cili gjithsesi jetonte vetëm në Romë dhe vdiq një vit pas emërimit. (Akademia u angazhua ta sillnin trupin në Firence, duke bërë që të varrosej në bazilikën e Santa Kroqes).

Mes pjesëmarrësve në akademi mes shek.15 dhe 16 ishin, mes të tjerësh, Benvenuto Celini, Xhambolonja, Bronzino, Andrewa Sansovino, Bartoomeo Amanati etj. Midis shkencëtarëve që u morën me shkollimin shkencor që Galileo Galilej.

Një modernizim dhe racionalizim i parë i organizimit akademik u krye në sajë të Pietro Leopoldos të Toskanës, që më 1784 ja ndryshoi edhe emrin me atë që ka sot. Në fund të shek.18 Antonio Kanova bëri të mundur të vinin kalket e ornamentece të Pantuonit. Më 1872 u soll edhe Davidi i Mikelanxhelos.

Midis fundit të shek.18 dhe shekullit të 19 edhe në Firence patën vend diskutimet midis akademikëve tradicionalistë, si docentet dhe nxënësit Pietro Beuvenuti, Lorenzo Bartolini, Rafaelo Morgen dhe Xhovani Dupre dhe novatorëve, në mënyrë të veçantë macchiaioli, që i paraprinë impresionizmit, si Adriano Çoçoni Telemako Sinjorini, Silvestro Lega dhe Xhovani Fatori, ndonëse nuk u arrit në tone të ashpra si në Paris.

Midis artistëve të huaj që u nderuan të ishin profesorë të Akademisë figurojnë Zhak-Lui David, Zhan-Ogyst-Domenik Ingres etj.

Midis mjeshtërvë të shek. 20-të që kanë punuar apo dhënë mësim figurojnë: Antonio Berti, Gazione Bredo, Dino Kaponi, Ygo Kapokini, Felice Karna, Galileo Chini (mësues të A. Buzës në Akademinë e Firences), Prino Konti, Mikele Depalma, Perikle Facini, Oskar Galo, Kuinto Germandi, Xhuzepe Graciozi, Rodolfo Margesi, Kuinto Martini dhe Otone Rozai.

Buza është i pari shqiptar diplomuar në Akademinë e Firences, propozuar për asistent i pedagogut Galileo Chini por që dukej të kthehej në atdhe për të shlyer për 5 vjet detyrimet e bursës. Më vonë studioi në Firence, Bukurosh Sejdini (1937-41).

## GALIELEO ANDREA MARIA CHINI

(Firence 2 dhjetor 1873-23 gusht 1956) ka qenë piktor, grafist, arkitekt, skenograf, qeramist, një prej protagonistëve të stilit Italian Liverty.

Galileo Chini lindi në Firence, bir rrobaqepësi. Pas vdekjes së babait, regjistrohet në Shkollën e Artit të Sanda Koçes, në Firence, ku frekuenton kurset e dekoracionit.

Prej vitit 1895 deri më 1897 frekuenton me ndërrime Shkollën e lirë të Nudos të Akademisë së Arteve të Bukura të Firences.

Më 1896 themelon në Firence manifakturën "Arte della Ceramica" së bashku me Xhovani Vanucin, Xhovani Montelatiçin dhe Vitorio Xhuntin. Gjatë këtyre viteve punon në San Miniato, duke vizatuar afreske për shkollën e këshillit komunal dhe për kishën e San Domenikos.

Për punimet në qeramikë mori çmime në ekspozita Ndërkombëtare në Bruksel, Sankt Peterburg dhe Sen Lui. Angazhohet për një sere dekoracionesh dhe restaurimesh në kishën Santa Maria Maxhare në Firence, përveç një vargu afreskesh në Hotel Kavur (Brenda në Firence) dhe në Grand Hotel La Paçe në Montekatini.

Mban katedrën e kursit të dekoracioneve në Akademinë Mbretërore të Arteve të Bukura të Romës (1908-1911) dhe nis bashkëpunimet e para si skenograf teatror.

Më 1910, mbreti i Tailandës Rama V, pasi kishte admiruar punët e tij në Bienalen e Venecias, e fton të punojë në oborr, në Bangkok. Në qershor 1911 i hipi anijes në Gjenovë, drejt lindjes së largët. Tama V kishte vdekur. Atë e pasonte i biri Rama VI që ishte një njeri shumë i kulturuar. Ai e pret Chinin në Bangkok. Punon afreske në sallën e fronit të pallatit mbretëror dhe realizon një sere portretesh zyrtarë për familjen mbretërore. Kthehet nga Tailanda më 1913, duke sjellë në Itali një varg veprash të peizazhit dhe të ambientit, që i ekspozon më 1914 në ekspozitën e Seçesione Romana-S. Sjell edhe një koleksion reliktesh

orientale që më 1950 ia dhuron muzeut etnografik të Cheiversitetit të Firences.

Më 1915 jep mësim në Kursin e Stolisjes në Akademinë Mbretërore të Arteve të Bukura në Firence. Vizaton afreske në Pallatin komunal të Moontekatinit dhe për dhomën e Tregtisë të Firences. Ndërkohë intensifikon veprimtarinë si skenograf, duke arritur në bashkëpunimet e para me Xhakomo Puçinin për veprën "Xhani Skiki". Punon me Puçinin për "Turanolot".

Më 1927 merr katedrën e dekorimit piktoresk në Shkollën Mbretërore të Arkitekturës në Firence dhe më 1928 vizaton afreske për selinë milaneze të Shoqërisë Elektrike Montekatini. Më 1938 e lë mësimdhënien, sepse kishte arritur caqet e moshës.

Këto janë vitet (1928 – 1933) kur jep mësim në kursin për studion te Buza, që ndikoi në ruajtjen e personalitetit dhe inkurajimet për më tej. Ai e kërkoi si asistent por Abdurrahimi duhej të kthehej në atdhe.

Galileo Chini vdes më 23 gusht 1956 në shtëpinë e tij – studio, në Via del Girlandaio 52, në Firence.

**Shote Galica, 1974**

tush / letër  
27,3 x 38,7 cm


**Bajram Curri me luftëtarë, 1974**

tush / letër  
17,4 x 24,4 cm



**Rruga e dritës, 1966**

laps / letër  
21,5 x 30,5 cm



